



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1395 Prot.

Tiranë, më 19.04 2021

**Lënda:** Përcillet denoncimi i qytetarit B.M

**STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË  
ORGANIZUAR**

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SË SOCIALE**

**SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT**

**KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT**

**ORGANEVE DREJTUESE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Për dijeni:**

**OSBE/ODIHR**

**MISIONI I LIMITUAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE**

**PRANIA E OSBE-SË NË SHQIPËRI**

**DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI**

**AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMËRIKËS**

**AMBASADA BRITANIKE**

**Tiranë**

Pas nismës së bërë publike nga Presidenti i Republikës, ku u kërkohet qytetarëve të denoncojnë çdo parregullsi në lidhje me kryerjen e krimeve elektorale gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, pranë Institucionit të Presidentit të Republikës është administruar në rrugë elektronike shqetësimi i një qytetari, i cili ka paraqitur denoncimin e tij ndaj [REDACTED]

Sipas ankesës, qytetari pretendon se, [REDACTED] ka shfrytëzuar postin e saj si [REDACTED] duke përdorur makinën dhe karburantin e shtetit për fushatë, dhe duke kërcënuar qytetarët të votojnë për subjektin politik Partinë Socialiste. Qytetari bën me dije se, ndihet i rrezikuar nga kërcënimet e [REDACTED] dhe kërkon ndihmë nga organet ligj zbatuese.